

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË**

**VENDIM**

NR. 8 datë 5 / 2 /2014

**MBI STRUKTURËN DHE PAGAT E ADMINISTRATËS SË NDERMARJEVE  
DHE**

**INSTITUCIONEVE NË VARTËSI TE BASHKISË KORÇË**

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi mori në shqyrtim relacionin për strukturën dhe pagat në administratën e ndërmarrjeve dhe institucioneve në vartësi të Bashkisë Korçë dhe bazuar në Ligjin Nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes Vendore", i ndryshuar ,neni 32 ,gërma ç, Ligjin nr 8549 datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil",Ligjin nr.7961 datë 12.07.19995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë",Ligjin nr.185/2013 datë 02.12.2013 "Për buxhetin të vitit 2014",Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012"Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit",Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.3,date 17.01.2014 "Per Zbatimin e Buxhetit te Vitit 2014", "VKM nr.1619 datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve ,grupimin e njësive të qeverisjes vendore,për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore",i ndryshuar,si dhe Vendimin nr. 474 datë 16.06.2011 "Për përcaktimin e standarteve e të procedurave që duhet të ndiqen gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave të institucioneve të administratës publike".

**VENDOSI:**

**1.**Të miratojë strukturën e Ndërmarrjeve dhe Institucioneve në vartësi të Bashkisë Korçë me ndryshimet përkatëse si më poshtë:

**a.**Në Ndërmarrjen Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes , një nga pozicionet specialist i nivelit të lartë në sektorin e financës të mbyllet, ky sektor të ngelet me dy specialistë të nivelit të lartë dhe të krijohet pozicioni Përgjegjës i brigadës së prapavijës,me kategorine IIIa/1 dhe shtesën për funksion 33.000 lek.

Të ndryshoje shtesa për funksion e Përgjegjesit të sektorit të financës dhe e Përgjegjës të sektorit të shërbimeve mbështetëse nga 38.000 lek në 40.000 lek.

**b.** Të miratoje ndryshimin e emërimit të Qendres ekonomike në emërtimin e ri, Institucioni i Qëndres së Artit dhe Kulturës Korçë.NIPT-i të mos ndryshojë,të ngelet i njëjtë K54105001N .

Të miratojë fillimin e procedurave për asgjësimin e vulës së vjetër dhe fillimin e procedurave për marrjen e vules së re me emërtimin e ri të institucionit.

Përgjegjësi i Qëndrës ekonomike të emërtohet Përgjegjës për financat e Qëndrës së Artit dhe Kulturës.

Ky institucion të ketë 1-drejtor të përgjithshëm i cili të paguhet me kategorinë I.b,me pagën bazë 14.000 lek dhe shtesën për funksion 60.000 lek dhe të ketë në varësi tre Institucionet e mëposhtme:

-Qëndrën kulturore "Vangjush Mio"

-Bibliotekën "Thimi Mitko"

-Teatrin "A.Z.Çajupi"

Në tërësi Institucioni i Qëndrës së Artit dhe Kulturës Korçë" të ketë 48 punonjës.

**c.** Në"Qëndrën Kulturore "Vangjush Mio",shtesa për funksion e drejtorit të ulet me 3000-lek, nga 40.800 lek të bëhet 37.800 lek.

Pozicioni "Ruajtes fondi" të mbyllet dhe detyrat që rrjedhin nga ky pozicion ti bashkangjiten pozicionit"Garderobier,rekuzitier,magaznier,i cili të marrë emertimin "Garderobier,rekuzitier,magaznier dhe Ruajtes Fondi".

Pozicioni "Koordinatorë per marrëdhënien me publikun"të **mbyllet**.

Struktura nga 15 punonjës të bëhet me 13 punonjës.

**ç.**Në Bibliotekën "Thimi Mitko", shtesa për funksion e drejtorit të ulet me 3000 lek, nga 38.800 lek të bëhet 35.800 lek.

Të ndryshojë emërtimi për pozicionin e "punonjësit mirëmbajtje salla e kompjuterave" në "punonjës mirëmbajtjeje salla e projekteve".

Të shkurtohet pozicioni "Roje".

Struktura nga 12 punonjës të bëhet me 11 punonjës.

**d.**Në Teatrin "A.Z.Çajupi",shtesa për funksion e drejtorit të teatrit të ulet me 3000 lek, nga 42.000 lek të bëhet 39.000 lek.

Kategoria për pozicionin menaxher artistik të ndryshoje nga IV.a në III.b dhe shtesa për funksion nga 19.110 lek të bëhet 23.520 lek.

**dh.**Të ndryshohet klasifikimi i kategorive për përgjegjësat,specialistët e nivelit të lartë dhe specialistët sipas kërkesave të ligjit:

-përgjegjësat në kategorinë IIIa/1

-Specialistët e nivelit të lartë,inspektorë në kategorine III.b

-Specialistët e nivelit të mesëm në kategorine IV.a